

Fier, më 20/07/2020

Ftesa për oferte

Titulli i Projektit: **Rise-Alb**
Referenca e Kontratës: **Nr. Ref. AID 011864**
Objekti prokurimi: **Prokurimi per ndertimi inkubatori ne kuader te projektit Rise-Alb**
Shuma totale e planifikuar: **18.337.633,00 Leke me TVSH**

Ju ftojme te merrni pjese ne prokurimin me objekt **ndertimi inkubatori ne kuader te projektit Rise-Alb**.

Ju do të paraqisni oferten tuaj ne tre zarfa te ndare sipas menyres se meposhtme. Dokumentat duhet te jene ne gjuhen shqipe.

Ne zarfin e pare te titulluar Dokumentat e parakulifikimit duhet te vendosen dokumentat e meposhtme:

1. Nje CV te kompanise ku te tregohen punimet e ngjashme te mepareshme;
2. Licencen e kompanise dhe nje list me punonjesit e stafit teknik;
3. Kopje te certifikatave ISO (ISO 9001, 14001, 50001, SA 8000, BS OHSAS 18001);
4. Nje list te paisjeve qe ka ose te marra me qera nga operatori ekonomik;
5. Nje dokument te 3-muajve te fundit qe vërteton se (subjekti juaj) ka plotësuar detyrimet fiskale dhe ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, te lëshuar nga Administrata Tatimore ne vendushtrimin e aktivitetit;
6. Kopje të vërtetuar të bilancit për tre vitete e fundit të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuar nga ky autoritet, ku vlera te jete jo me e vogel se dyfishi i fondit limit qe prokurohet;
7. Një vertetim të gjendjes financiare nga një banke qe verteton se shoqeria ka nje llogari rrjedhese;
8. Depozitimi i nje garancie bankare per tenderin te barabarte me 2% te vleres se fondit limit.

Mungesa e nje prej dokumentave te mesiperme do te sjell ne skualifikimin e subjekteve.

Zarfi i dyte i titulluar Oferta Teknike duhet te perfshije Relacionin Teknik dhe duhet te perfshije dokumentat teknike te meposhtme:

1. Raport teknik dhe grafikun e punimeve;
2. CV te stafit te tij teknik qe do te ndjek punimet e ndertimit;
3. Relacion teknik te cilesise te materialeve te ndertimit qe do te perdoren.

Zarfi i trete i titulluar Oferta Ekonomike duhet te perfshije oferten ekonomike.

Gjatë vlerësimit të ofertave Autoriteti Kontraktor do të përcaktoje për çdo propozim çmimin e vlerësuar duke bere korrigjimin për gabimet aritmetike si me poshtë;

1. aty ku ka mospërputhje midis shumave në shifra dhe në fjalë, do të merren parasysh shumat me fjalë;
2. aty ku ka mospërputhje midis çmimit njësi dhe totalit të artikullit të linjës që rezulton nga shumëzimi i çmimit njësi me sasinë, çmimi njësi siç ofrohet duhet të merret parasysh;

Në qoftë se ofertuesi refuzon të pranojë korigjimet, oferta e tij do të refuzohet.

Vleresimi i ofertave do të kryhet sipas kriterëve ku Oferta Teknike do të vlerësohet me 70 pike dhe Oferta Ekonomike do të vlerësohet me 30 pike.

1. Kapaciteti për tendera, burimet, kompetenca dhe eksperiencat të mëparshme në të njëjtën fushë: 20 pikë;
2. Metodologjia e propozuar, qasja dhe plani i zbatimit: 20 pikë (vlerësuar bazuar në pikën 1 të ofertës teknike);
3. Cilësia e materialeve që do të përdoret dhe përmirësimet e mundshme që mund të propozohen: 20 pikë (vlerësuar bazuar në pikën 3 të ofertës teknike);
4. Personeli i propozuar që do të zbatoj projektin: 10 pikë (vlerësuar bazuar në pikën 2 të Ofertës Teknike);
5. Oferta Ekonomike: 30 pike.

Metodologjia si do të llogaritet vleresimi për çdo ofertë ekonomike do të kryhet sipas formulës së mëposhtme:

P(piket) = $[VP_{min}/P_{of}] \times 30$; (që do të thotë = rrendja katrore e Ofertes minimale përmbi ofertën e paraqitur shumëzuar me 30)

P_{min} = oferta më e ulët

P_{of} = oferta e paraqitur

Kushtet jo normale

Në analizën ekonomike të ofertave përpara se të aplikoni formulën e përshkruar më sipër, e cila përcakton vlerësimin ekonomik do të skualifikohen oferta që janë më të ulëta sipas formulës së mëposhtme:

Ba = Fondi limit
 O = Ofertat
 MO = Mesatarja e ofertave
 n = Numri i ofertave
 Ra = Pranohet më poshtë

$$MO = O_1 + O_2 + O_3 + \dots + O_n/n;$$

$[Ba - MO]$ = diferenca midis fondi limit dhe mesatares së ofertës

$$Ra = [Ba - MO] + 1/5 \times [Ba - MO];$$

$$[Ba - O] \leq Ra$$

Diferenca midis çmimit të ankandit (Ba) dhe ofertës që vlerësohet (O) duhet të jetë më e ulët ose e barabartë me Ra. Në rastet kur oferta nuk plotëson kushtin e mesipër, ajo do të konsiderohet jo normale dhe do të skualifikohet pa të drejtë kundërshtimi.

Oferta ekonomike mund te marr maksimumin 30 pike.

Fitues do te shpallet ofertuesi qe ka vleresimin me te lart sipas formules se meposhtme:

Vleresimi Total = Piket Teknike + Piket Ekonomike.

Autoriteti Kontraktor do te njoftoj fituesin e tenderit per nenshkrimin e kontrates dhe fillimin e punimeve ne nje date qe do te percaktohet me vone.

Autoriteti Kontraktor ka te drejten qe te anulroj tenderin per raste te fuqise madhore pa te drejte kundershimi nga ana e pales fituese.

Per cdo paqartesi mund te kontaktoni ne: sokol.belaj@engiminternazionale.org - 0672305801

Ofertat duhet te dorezohen ne zarfa te mbyllur dhe te vulosur jo me vone se ora 17:00, data 21/08/2020 ne adresen e meposhtme:

ENGIM ALBANIA

L. "29 Nentori", Rr. Pinellopi Pirro, P. "Arditi 06", 9301, Fier